



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Prej: Nazmi Mikullovc, Kryesues i Bordit të Drejtorëve, AKP

Arben Limani, Drejtor Menaxhues, AKP

Data: 8 korrik 2022

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

të Zyrës Kombëtare të Auditimit  
në Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2021  
për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
A1.	Paga dhe mëditje	Parregullsi në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Kryesuesi i Bordit, me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimit të aktiviteteve normale të të gjitha njësive, duhet të siguroj që respektohen	a) Është adresuar çështja e ngritjes së pagave për vozitësit duke anuluar më 4 mars 2022 vendimin e Drejtorit Menaxhues të datës 4 shtator 2019. Çështja e përgjegjësisë së menaxherëve të kontratave do të adresohet në kuadër të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregullores së Qeverisë për Disiplinën e Nëpunësve Publik.	Menaxhmenti Departamenti i Burimeve Njerëzore	a) Konsiderohet e zbatuar me anulim të vendimit të datës 04.03.2022  b) deri 31 dhjetor 2022

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
			kërkesat ligjore në lidhje me transferimet e përkohshme të stafit si dhe lidhjen dhe zbatuesmerinë e kontratave	<p>b) Sa i përket transfereve të përkohshme, janë rishikuar të gjitha rastet dhe për ato që nuk ka patur nevojë, nuk u është vazhduar angazhimi. Ndërsa për rastet që janë ende si transfere të përkohshme janë për shkak të nevojës për angazhim duke marrë parasysh mungesat e stafit në departamentet dhe njësitë përkatëse dhe deri në hapjen e procedurave të konkursit këto raste do të mbesin si transfere të përkohshme.</p> <p>Agjencia ka filluar procesin e ristrukturimit të tërësishëm dhe parashihet të adresohen edhe çështjet e transfereve të përkohshme dhe të përhershme.</p>		
A2.	Menaxhimi Kontratës	Mos penalizmi i operatorëve ekonomik dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit	Kryesuesi i Bordit duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të	<p>a) Më datë 28 shkurt 2022 është marrë vendim nga Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues (DM 278/2022) që Menaxherët e Kontratave të bëjnë harmonizimin e rregullt mujor të pagesave për kontratat e prokurimit.</p> <p>Kjo nënkupton që çdo devijim nga kontratat duhet të raportohet te Departamenti i Prokurimit, mbikqyrësit e Menaxherëve të Kontratave dhe te Menaxhmenti.</p>	<p>Departamenti i Prokurimit</p> <p>Menaxherët e Kontratave</p> <p>Mbikqyrësit e Menaxherëve të Kontratave</p>	<p>a) Zbatohet në vazhdimësi për shkak të datave të ndryshme të përfundimit të kontratave gjatë vitit 2022;</p> <p>b) 30 shtator 2022.</p>



Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
			ndodhin në të ardhmen.	<p>b) Do të përgatitet një Udhëzues i brendshëm për menaxhimin e kontratave që do të bazohet në Ligjin e Prokurimit Publik dhe në Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik të miratuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.</p> <p>Sa i përket rasteve të paraqitura nga ZKA në këtë të gjetur, Agjencia do t'i adresoj sipas procedurave të Ligjit për Zyrtarët Publik.</p>		
B2	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Mos funksioni i sistemit të E - Pasuria	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj vazhdimin e bashkëpunimit aktiv me MPBAP, për eliminimin e mangësive në sistemin e-pasuria, përfshirë edhe bartjen e shënimeve të pasurive jo kapitale.	<p>Do t'i dërgohet letër Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për të kërkuar që të zbatohet sistemi E-pasuria për nevojat e AKP-së.</p> <p>Kjo do të mundësoj që qe ne bashkëpunim me MPBAP te arrihet zbatimi praktik i sistemit E- Pasuria.</p> <p>Siç është shënuar në raportin final të ZKA-së, me gjithë vullnetin e AKP-së për funksionalizimin e këtij sistemi, kjo çështje nuk varet nga AKP, por në tërësi nga zbatimit i Sistemit E-pasuria nga ana e MPB-së.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Administratës Publike;</li> <li>- Departamenti i Financave dhe Buxhetit (Zyrtari i Pasurisë);</li> </ul>	31 dhjetor 2022